

VENDIM
Nr. 485, datë 1.8.2023

**PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI AUTORITET
KONTRAKTOR PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS
MULTIFUNKSIONALE PËRRETH KOMPLEKSIT TË STADIUMIT “NIKO
DOVANA” NË DURRËS, PËRFSHIRË STADIUMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për zbatimin e projektit për zhvillimin e zonës multifunktionale përreth kompleksit të stadiumit “Niko Dovana” në Durrës, përfshirë stadiumin.

2. Në funksion të zbatimit të projektit të përcaktuar në pikën 1, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratat përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e tyre e të projektit përkatës, duke përdorur fonde nga programet aktuale të zhvillimit;

b) paraqitjen e kërkesave për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit pranë autoritetit kompetent të zhvillimit të territorit, si dhe ndjekjen e të gjitha veprimeve e të procedurave të nevojshme për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin e territorit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Bashkia Durrës lidhin marrëveshje bashkëpunimi në funksion të zhvillimit të projektit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia Durrës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama